

DEKLARIMI I SHPENZIMEVE

Zëri në Buxhet

“Equipment”

Zëri i buxhetit të projektit “Equipment” i referohet shpenzimeve për blerjen/ marrjen me qera/ marrjen me leasing të pajisjeve në funksion të zbatimit të aktiviteteve të projektit. Në kategorinë “Equipment” / pajisjet, do të klasifikohen:

- pajisjet elektronike, përfshirë këtu, kompjuter, printer, software- hardware etj.....,
- pajisjet për mobilimin e zyrës,
- apo makineri të posaçme në përmbushje të kërkesave specifike të projektit.

Të gjitha pajisjet duhet të jenë qartësisht të parashikuara në Formatin e Aplikimit. Në rast se nuk janë parashikuar, atëherë duhet të jetë rënë dakort paraprakisht me MA¹/ JTS² dhe/ ose me JMC³ në mënyrë që blerja/ marrja me qera/ marrja me lising të konsiderohen si shpenzim i rregullt.

Per deklarimin e shpenzimeve nen zerin Equipment duhet ti referoheni **DETYRIMISHT** kerkesave te publikuara ne seksionin “5.3.7 Equipment” te manualit udhezues te Programit IPA Adriatik - PMCM⁴.

¹ MA- Managing Authority/ Autoriteti Menaxhues i Programit IPA Adriatik me vendndodhje ne Láquila Italy për kontakte kliko <http://www.adriaticpacbc.org/index.asp?page=interna&level=contacts>

² JTS- Joint Technical Secretariat/ Sekretariati i Perbashket Teknik i Programit IPA Adriatik me vendndodhje ne Láquila Italy për kontakte kliko <http://www.adriaticpacbc.org/index.asp?page=interna&level=contacts>

³ JMC- Joint Monitoring Committee/ Komiteti i Përbashkët i Monitorimit me anëtarësi nga të 8 shtetet pjesëmarrëse të Programit IPA Adriatik: Itali, Shqiperi, Greqi, Mal i Zi, Serbi, Bosnje dhe Hercegovina, Kroaci dhe Sloveni.

⁴ Program Management and Control Manual (PMCM) http://www.adriaticpacbc.org/index.asp?page=interna&level=implementation_documents faqe 60-63.



Kujdes: * *Të gjitha pajisjet dhe materialet e blera me fonde të financuara nga Programi IPA Adriatik duhet të kenë origjinën⁵ në një shtetet anëtare të Komunitetit ose në një nga vendet e ligjshme për ndihmën e jashtme^{6 7}.*

Heqja e rregullit të origjinës⁸

Në kuader të Programit IPA Adriatik çdo përfituesi final Shqiptar i njihet e drejta të përfitojë nga *heqja e rregullit të origjinës*, pra blerjen e pajisjeve dhe materialeve për zbatimin e aktiviteteve të projektit, me origjinë të ndryshme nga ajo e cituar në footnote 7 (si më poshtë).

Në Programin IPA Adriatik të drejtën për të autorizuar *heqjen e rregullit të origjinës* është kompetencë vetëm e Autoritetit Menaxhues⁹.

⁵ Termi “origjinë” për qëllime të nenit 19 paragrafi 5 i Rregullores IPA 1085/ 2006 është i përcaktuar në legjislacionin përkatës komunitar për rregullin e origjinës për çështje doganore, neni 23 dhe 24 i Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 2913/ 92 I 12 Tetorit 1992. *Neni 23.1. Mallrat që e kanë origjinën nga një vend, janë ato të cilat janë tërësisht të prodhuara apo të realizuar në këtë vend. Neni 24, mallrat për të cilat prodhimi përfshin më shumë se një vend do të konsiderohen se e kanë origjinën në atë vend ku ato i janë nënshtruar modifikimit të fundi.*

⁶ Sipas nenit 19 të Rregullores IPA “... Pjesmarrja në një procedurë prokurimi ose në një kontratë grandesh, të financuar nga kjo rregullore do të jetë e hapur për aplikim për të gjithë personat natyral të cilët janë shtetas, dhe për të gjithë personat juridik të cilët janë rregjistruar, në një vend anëtar të BE, vendi i cili është përfitues i kësaj rregulloreje, vendi i cili është përfitues nga Instrumenti i Bashkëpunimit Europian, ose një vend anëtar i Zonës Ekonomike Europiane, ose në një vend tjetër nga ata ku bashkëpunimi reciprok i asistencës së jashtme është vendosur...”. Kjo nënkupton që përveç *27 vendeve anëtare të BE*, përfshihen edhe *vendet IPA* : Kroacia, Turqia, Ish Republika e Maqedonisë, Shqipëria, Bosnja, Mal i Zi, Serbia, Kosova. Gjithashtu *vendet ENPI* : Algjeria, Armenia, Azerbajxhan, Bjellorusia, Egjipti, Gjerogjia, Izraeli, Jordania, Libani, Libia, Moldavia, Maroku, Palestina dhe Rripi i Gazës, Federata Ruse, Siria, Tunizia, Ukraina dhe *Vendet EFTA* : Litenshtejni, Islanda, Norvegjia dhe Zvicera.

⁷ Për më shumë informacion referoju materialit të përgatitur nga Interact, Janar 2012 “Derogation to the Rule of Origin in IPA CBC programmes” - a Factsheet -January 2012.

⁸ Derogation from the rule of origine

⁹ Managing Authority / Regione Abruzzo / Direzione Affari della Presidenza, Politiche Legislative e Comunitarie Programmazione Servizio Cooperazione Territoriale - IPA Adriatico – Address: Via Salaria



Autoritetit Menaxhues (MA) i Programit IPA Adriatik do të shprehet për heqjen ose jo të rregullit të origjinës vetëm pasi Drejtuesi Lider i Projektit në zbatim, dërgon një kërkesë zyrtare sipas formatit të letrës standarte të publikuar në web site të programit¹⁰

Kujdes: Të gjitha shpenzimet nën këtë kategori duhet të respektojnë rregullat e prokurimit në zbatim të nenin 121 të Rregullores Zbatuese IPA 718/2007¹¹.

I.) Blerja e Pajisjeve

Në rastet kur pajisjet e blera përdoren ekskluzivisht për qëllimet e projektit aplikohen dy mundësi:

- A.** kosto e plotë e pajisjeve/ kosto 100 % mund ti ngarkohet shpenzimeve të projektit;
- B.** aplikimi i metodës të amortizimit.

Antica Est, 27 -67100 L'Aquila Tel. +39 0862 364285, Fax.+39 0862 322520 ; E-mail: managingauthority@adriaticpacbc.org .

¹⁰ http://www.adriaticpacbc.org/index.asp?page=interna&level=implementation_documents seksioni "Procurement rules" – "Rule of Origine".

¹¹ Referoju seksionit "4.2. Public procurement" te PMCM faqe 32. Në përputhje me nenin 121(1) të rregullores së implementimit IPA, procedurat e prokurimit në të gjithë zonën e programit ndërkufitar si në vendet anëtare, dhe në vendet përfituese duhet të ndjekin dispozitat e Kapitullit 3 të pjesës 2, Titulli IV të rregullores financiare dhe Kapitulli 3 i pjesës 2, Titulli III të rregullores së komisionit (EC, Euroatom) nr.2342/2002 të datës 23 dhjetor 2002 5 që parashikojnë rregullat për implementimin e rregullores së Këshillit (EC, Euroatom) nr.1605/2002 si dhe vendimin e Komisionit C(2007)2034 mbi "Rregullat dhe procedurat për kontratat e shërbimeve, pajisjeve dhe punimeve të financuara nga buxheti i përgjithshëm i Komuniteteve Evropiane për qëllime bashkëpunimi me vendet e treta".

Përfituesit Shqiptarë janë të sygjerruar ti referohen "Practical Guide to Contract procedures for EU external actions" – të njohura si "PRAG" http://ec.europa.eu/europeaid/work/procedures/implementation/practical_guide/index_en.htm dhe të plotësojnë formatet standarte të publikuara në këtë link (Supplies annexes _ 2012 templates c1 - c9) .
Kujtesë: Kërkesat e "PRAG" nuk janë të detyrueshme por vetëm indikative. Në cdo rast duhet të respektohen vetëm kërkesat e nenit 121 të Rregullore IPA 718/2007.



A) vlera 100% e pajisjeve është plotësisht/ 100% e ligjshme për rimbursim nëse provohet që:

o pajisja e blerë është në vlerë të vogël¹² dhe si rrjedhim nuk aplikohen rregullat e amortizimit,

ose

o periudha, nga dita e blerjes deri në fund të projektit, është më e gjatë ose e njëjtë me periudhën normale të amortizimit për cdo lloj pajisjeje;

ose

o periudha, nga blerja deri në ditën e mbylljes së projektit, është më e shkurtër se periudha normale e amortizimit, por:

- duhet që pajisja/ jet të përdoren nga partnerët e projektit dhe grupet e synuara të projektit për të njëjtin qëllim për të paktën 5 vitet e fundit pas përmbylljes së aktiviteteve të projektit,

ose

- pajisja/ jet janë pjesë e një qëllimi specifik në projekt (për shembull pajisjet e zyrës nëse qëllimi i projektit është ngritja e një qendre që do të ofrojë shërbime për grupet e synuara jo vetëm për gjatë periudhës së zbatimit të projektit).

Në të dyja këto raste, duhet të hartohet një deklaratë¹³ nga Përfituesi Final i projektit ku të përcaktohet që pajisja/ jet do të përdoren nga partneri në projekt dhe grupet e synuara/ të targetuara të projektit për të njëjtin qëllim për të paktën 5 vjet pas përmbylljes së aktiviteteve të projektit ose pajisja/ jet janë pjesë e një qëllimi specifik të projektit.

Kujtesë: Kjo deklaratë duhet të dërgohet në çdo kohë gjatë kohëzgjatjes të zbatimit të projektit, duke marrë në konsideratë që nëse është dërguar me Raport Progresin/ Progress Raportin e parë, e gjithë shuma mund të raportohet në këtë Progress Raport. Në rast të kundërt vetëm pjesa e shumës së llogaritur nga amortizimi duhet të raportohet. Në momentin e dërgimit të deklaratës, pjesa e mbetur e kostos të shpenzimit nga llogaritja e amortizimit duhet të raportohet për rimbursim në Raport Progresin e radhës.

Por në çdo njërin nga rastet e sipër përmendura, brenda 5 viteve nga mbyllja e projektit, Përfituesit duhet të shmangin çdo ndryshim substancial: që ndikon në natyrën e pajisjes,

¹² Të mos kalojë vlerën maksimale 500 euro.

¹³ Deklarata i dërgohet MA- Autoritetit Menaxhues të Programit IPA Adriatik



ose kushtet e tij të zbatimit, ose gjeneron të ardhura në favor të një institucioni publik apo privat apo që rezulton edhe nga ndyshimi i pronësisë.

Kujdes: ***Blerja e pajisjeve të përdorura (të dorës së dytë) nuk do të konsiderohet kërkesë e ligjshme për rimbursim.***

B) Metoda e amortizimit aplikohet në të gjitha ato raste kur nuk është e rimbursueshme e gjithë vlera e plotë e pajisjeve. Në këtë rast metoda e amortizimit do të llogaritet sipas kuadrit ligjor Shqiptar¹⁴, në rast se Përfituesi Final Shqiptar vepron dhe ushtron aktivitetet e projektit në territorin Shqiptar, në këtë rast kërkesa e amortizimit të pajisjeve do të deklarohet për rimbursim në mënyrë porporcionale në çdo Raport Progresi deri në fund të projektit. ***Kujdes: në çdo rast kostot e amortizimit nuk mund të tejkalojnë çmimin e blerjes së pajisjes.***

Llogaritja e metodës së amortizimit do të realizohet sipas shembullit të formulës të dhënë në faqen 62 të PMCM

Pajisjet që nuk përdoren ekskluzivisht për qëllimet e projektit

Në rastet kur pajisja/ jet përdoren nga stafi, punonjësitqë punojnë me kohë të pjeshme për projektin kërkesa për rimbursimin e pajisjeve do të kërkohet mbi baza ***pro-rata***¹⁵,

¹⁴ Per Institucionet Publike referoju *Udhëzimit nr. 14 date 28 / 12 / 2006 « Per pergatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore te vitit 2006 per institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njesive qe varen prej tyre si dhe te njesive te menaxhimit / zbatimit te projekteve e marrveshjeve me donatore te huaj »*. Për Subjektet Private referoju *Ligji 8438 datë 28.12.1998 « Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar »*

¹⁵ Mbi baza porporcionale



duke mbajtur parasysh këtu edhe metodën e amortizimit, sipas shpjegimeve të dhëna në paragrafin pararendës¹⁶.

II.) Marrja me qera e pajisjeve

Në kuadër të zbatimit të projekteve të financuara nga Programi IPA Adriatik është e mundur edhe marrja me qera e pajisjes/ pajisjeve, në të gjitha ato raste që provohet se marrja me qera është mënyra më ekonomike apo efiçente¹⁷ në funksion të realizimit të aktiviteteve të projektit në zbatim.

Dokumentat që duhet të paraqiten tek FLCO Shqiperi për raportimin e zërit në buxhet pajisjet (equipment)

Dokumentat e mëposhtëm, duhet të paraqiten domosdoshmerisht në zyrën e FLC, në mënyrë që të proçedohet me rimbursimin e shpenzimeve:

- Dokumentat që evidentojnë që opsioni i kostos më efiçente është zgjedhur;
- Dokumentat që provojnë që rregullat e prokurimit publik janë respektuar;
- Planin e amortizimit të përshtatur për çdo pajisje të blerë në përputhje me rregullat kombëtare (ligjin Shqiptar në këtë rast);
- Për pajisjet të cilat përdoren pjesërisht për qëllimet e projektit duhet të bashkangjitet deklarata e metodës së llogaritjes për ndarjen e kostos me buxhetin e projektit;
- Të gjitha pajisjet dhe materialet e blera me fonde të financuara nga Programi IPA Adriatik duhet të kenë origjinën në një shtetet anëtare të Komunitetit ose në një nga vendet e ligjshme për ndihmën e jashtme. Për të provuar këtë fakt duhet të paraqitet detyrimisht certifikata e origjinës së pajisjes së blerë. Në çdo rast

¹⁶ B. Metoda e amortizimit.

¹⁷ Kjo mund të provohet nëpërmjet kryerjes së studimit të tregut nga një komision ekspertësh (jo më shumë se 3 punonjës) ngritur për këtë qëllim nga Drejtuesi i Projektit në zbatim.



respektimi i “rregullit të origjinës” do të jetë pjesë e verifikimit nga kontrollorët e zyrës së FLC Shqipëri në ambientet e ushtrimit të veprimtarisë të përfituesit.

- Në rastet e autorizimit për mos aplikimin e rregullit të origjinës, duhet të dorëzohet kopje e njehësuar me origjinalin¹⁸ e “Autorizimit të lëshuar nga Autoriteti Menaxhues i Programit IPA Adriatik”.
- Kopje e njehësuar me origjinalin e Kontratës së lidhur midis blerësit- partnerit në projekt dhe shitësit, ku të jenë përcaktuar qartë lloji, cilësia, sasia dhe çmimi për njësi i pajisjeve që do të blihen.
- Faturën fiskale të detajuar, në të cilën të shprehet qartësisht data, paguesi dhe përfituesi, dhe kur është e mundur edhe titulli/ shkurtimi i titullit të projektit dhe emri i programit, përshkrim i detajuar i pajisjeve të blera, të marra me qera apo leasing, llogaritjen, çmimin për njësi (nëse është e mundur) dhe çmimin total;
- Kur është e mundur, deklaratën që përcakton se pajisja/ pajisjet janë përdorur nga partnerët e projektit dhe grupet e targetuara të projektit për të njëjtin qëllim për të paktën pesë vjet pas përmbylljes së aktiviteteve të projektit ose që pajisja/et janë pjesë e një qëllimi specifik të projektit.
- Dokumentat që provojnë se shpenzimi është kryer realisht psh, është lëshuar urdhëri i shpenzimi i firmosur nga banka apo nga menaxheri financiar apo menaxheri administrative i projektit;
- Transfertat bankare për të vërtetuar që shpenzimi është kryer realisht, apo kopjen e urdher xhirimit ku të jetë e dukshme firma dhe vula e bankës, ose kopjen e mandatit të pagesës së bankës.
- Në sistemin MIS përpara se të mbyllet Raport Progresi duhet të ngarkohet (uplodohet) “Contract award declaration”¹⁹. Një kopje të këtij dokumenti duhet të

¹⁸ Referoju shpjegimeve të dhëna në pjesën “Shënime” pika iii

¹⁹ Këtë dokument e gjeni të publikuar në website të programi http://www.adriaticpacbc.org/index.asp?page=interna&level=implementation_documents referoju “Reporting Pack – Contract award declaration”.



bashkangjitet dokumentave mbështetes që do të dërgohen në zyrën e FLC.
Kujdes : Mungesa në dokumentat mbështetës të “Contract award declaration” do te sjelli vonesa per leshimin e DVE nga zyra e FLC.

- Përfituesit Final Shqiptar për të gjitha shpenzimet e kryera nën këtë kategori duhet të sigurojnë që:
 - o pajisjet nuk janë financuar nga kontrata të tjera financiare të lidhura me institucionet e EU, si ato kombëtare apo rajonale,
 - o nuk janë amortizuar totalisht
dhe
 - o nuk janë kërkuar për rimbursim në një zë tjetër buxheti “overheads” apo ndryshe zeri “shpenzime të tjera”

Shenime: *i. Ekzistenca e pajisjeve të projektit do të jëtë pjesë e verifikimeve nga FLCO nënëpërmjet kontrolleve on-the-spot checks²⁰.*

ii. Për pajisjet e blera në kuadër të Programit IPA Adriatik duhet të respektohen rregullat e publicitetit²¹ në mënyrë që të konsiderohen si shpenzim i ligjshëm.

*iii. Dokumentat e specifikuar në paragrafët e mësipërm do të dërgohen pranë zyres te FLCO²² vetem pasi te jene anuluar sipas te dhenave te shpjeguara ne PMCM seksionin “6.1.1.3. Voiding expenditure documents” (faqe 72-73) dhe seksionit “6.1.2.3. Attachments to the Progress Report (supporting documents)” faqe 74-75 (shiko edhe footnote 74). *Kujdes: Mos plotesimi i dokumentave sipas kerkesave ne seksionet e siperpermendura do te sjelle vonesa per leshimin e DVE nga zyra e FLC.**

²⁰ Janë kontrolle që realizon FLCO në vendndodhjen/ vendin e punës apo vendin ku ushtrohet aktiviteti i projektit për të verifikuar në vend ekzistencën dhe funksionimin real të pajisjeve të blera në kuadër të zbatimit të projektit.

²¹ Referoju rregullave të seksionit 7 Publicity rules të PMCM

²² Adresa zyrtare: **Zj. Daniela Çekani/ Sekretare e Pergjithshme, Ministria e Integrimit, Rruga Papa Gjon Pali II, Tirane Shqiperi.**

